



SHPALLJE

PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENT

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin **"Krijimi i vendeve të punës në bujqësi"** projekt 18 muajsh (2020-2022). Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Aktivitetet e projektit në pjesën e Malit të Zi do të zbatohen nga Kryeqyteti Podgorica, kurse në pjesën e Kosovës (Pejë dhe Istog), zbatuese e aktiviteteve të projektit është IADK.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar edhe përkrahja e të rinjëve-studentëve me punë praktike, si mundësi për punësim apo vetë-punësim. Përmes këtij aktiviteti paraprakisht do të organizohen pesë (5) ditë trajnime profesionale të aftësive të buta. Pas përfundimit të trajnimeve, studentët do të sistemohen në punë praktike në kompani që merren me grumbullimin, kultivimin, tharjen, përpunimin dhe eksportimin e bimëve mjekësore dhe aromatike apo të produkteve pyjore jo-drusore. Këto aktivitete do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse ku shtrihet projekti.

Andaj **ftohen** të rinjtë-studentët e drejtimit të bujqësisë dhe agro-përpunimit, që të aplikojnë për angazhimin në punë praktike që përshtatet me profesionin e tyre. Gjatë zbatimit të projektit do të përkrahen gjithsej 20 të rinjë-student me punë praktike. Gjatë punës praktike në periudhë prej 3 muajve, të rinjtë/studentët do të kenë një kompensim në baza mujore për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit. Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret bazë të përcaktuara në projekt.

KRITERET BAZË QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË:

- Student të cilët kanë diplomuar (më së paku nivel bachelor) në drejtime të bujqësisë dhe agro-përpunimit;
- Studentët të papunë dhe që nuk kanë kryer praktikë më parë;
- Studentët që shprehin gatishmëri/përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe në punën praktike në kompani/agrobiznese;
- Studentët të interesuar për praktikë duhet të jenë nga këto komuna: Pejë dhe Istog;

Aplikacioni mund të merren në **zyrat e IADK-së dhe zyrat për bujqësi në komunat Pejë dhe Istog**, ose mund t'i kërkon në e-mailin: behare.mlinaku@gmail.com apo behare.mlinaku@iadk.org. Aplikacioni duhet të dorëzohet në zyrat e IADK-së apo zyrat për bujqësi në komunat përkatëse: Pejë (person kontaktues Mehdi Mulaj) dhe Istog (person kontaktues Kushtrim Zogaj) ose në e-mailat e lartëcekur.

Aplikacionet duhet të dorëzohen deri me datë 30.11.2020.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në +383 49 904 918.

Sinqerisht

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



MNE - KOS

PROGRAMI IPA I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020